

ALBANIAN GREEN ENERGY sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E PERFORMANCËS	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	8 - 26

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e Shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes së përshkruar në bazat për opinion me rezervë pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinion me Rezervë

Siç parashikohet në Standardin Kontabel të Kontabilitetit numër 13 Aktivitet biologjike dhe marrëveshjet konçesionare në fuqi nga viti 2014, marrëveshja e konçesionit duhet të ishte trajtuar si një aktiv afatgjatë jomaterial dhe të amortizohej në mënyrë lineare në përpudhje me jetëgjatësinë e marrëveshjes. Për pasojë, paraqitja e investimit në hidrocentrale si Aktive Afatgjatë Material të klasifikuara në zërat e ndërtesës dhe makineri e pasisjeve, nuk është në përputhje me kërkesat e SKK 13. Bazuar në informacionin që kemi, ne nuk jemi në gjendje të përlllogarisim efektet që trajtimi i marrëveshjes së konçesionit sipas kërkesave të SKK 13 në vend të SKK 5 do të kishte në amortizimin e vitit, amortizimin e akumuluar dhe rezultatet e mbartura.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 2.5.3 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi. Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

mazars

 Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIS: K32123006W

26 mars 2021

Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	63,811,244	36,791,331
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	32,434,013	37,317,714
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	1,053,457	4,835,009
Inventarë	7	400,627	56,640
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	1,701,632	1,594,574
Totali i aktiveve afatshkurtra		99,400,973	80,595,268
Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	178,783,066	190,891,518
Totali i aktiveve afatgjata		178,783,066	190,891,518
Totali i aktiveve		278,184,039	271,486,786
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	10	2,691,693	8,750,126
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	11	13,479,465	23,425,607
Detyrime tatimore	12	4,800,723	6,183,225
Të tjera detyrime	13	4,277,950	20,472,751
Totali i detyrimeve afatshkurtra		25,249,831	58,831,709
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		25,249,831	58,831,709
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000,000	100,000,000
Rezerva ligjore		10,249,911	10,249,911
Rezerva të tjera		102,405,166	70,483,650
Fitimi i ushtrimit		40,279,131	31,921,516
Totali i kapitalit	14	252,934,208	212,655,077
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		278,184,039	271,486,786

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Green Energy sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	206,434,866	244,373,807
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	16	1,583,754	(107,697)
Total të ardhura		208,018,620	244,266,110
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(94,881,109)	(140,224,355)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	17	(78,778,512)	(126,040,778)
2) Të tjera shpenzime	18	(16,102,597)	(14,183,577)
Shpenzime të personelit	19	(45,228,654)	(45,579,206)
1) Paga dhe shpërblime		(40,751,016)	(41,013,913)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(4,477,638)	(4,565,293)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(17,695,933)	(18,943,662)
Provizione dhe zhvleresime	20	(2,000,000)	(1,144,331)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(1,043)	(104)
Shpenzime financiare		1,296	(158,108)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	22	1,296	(156,837)
2) Shpenzime të tjera financiare	23	-	(1,271)
Fitimi/humbja para tatimit		48,213,177	38,216,344
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(7,934,046)	(6,294,828)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	24	(7,934,046)	(6,294,828)
Fitimi/humbja e vitit		40,279,131	31,921,516
Total i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Total i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		40,279,131	31,921,516

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albanian Green Energy sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Statutore dhe Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 01 Janar 2019	100,000,000	10,249,911	65,911,568	66,572,082	242,733,561
Fitim/humbja e vitit				31,921,516	31,921,516
Transferim i fitimit të vitit në rezerva			66,572,082	(66,572,082)	-
Dividendë të paguar			(62,000,000)		(62,000,000)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100,000,000	10,249,911	70,483,650	31,921,516	212,655,077
Fitim/humbja e vitit				40,279,131	40,279,131
Transferim i fitimit të vitit në rezerva			31,921,516	(31,921,516)	-
Dividendë të paguar					-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	100,000,000	10,249,911	102,405,166	40,279,131	252,934,208

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori i Albanian Green Energy sh.p.k më 18 mars 2021 dhe janë firmosur si më poshtë.


Eugenio Rossatto
P.A. TOP / Administrator


Nexhmije Saraçi
Financiere

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	40,279,131	31,921,516
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	22,325	173,804
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	116,818	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	17,695,933	18,943,662
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	13,060,290	(9,639,017)
Rënie/(rritje) në inventarë	(343,987)	320
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(33,790,604)	10,210,109
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(107,058)	369,937
Tatim mbi fitimin e paguar	(4,395,037)	(6,294,828)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	91,908	(11,916)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	32,629,719	45,673,587
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata material	(5,587,481)	(14,255,081)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(5,587,481)	(18,331,332)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Interes i arkëtuar/ (i paguar)	1,296	(156,837)
Dividendë të paguar	-	(62,000,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	1,296	(72,888)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	27,043,534	(30,738,331)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	36,791,331	67,546,629
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit	(23,621)	(16,967)
Mjetet monetare në fund të periudhës	4 63,811,244	36,791,331

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 26, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Albanian Green Energy Shpk është krijuar më 21/12/2006.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008, "Për Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj. Shoqëria Albanian Green Energy Shpk është shoqëri shqiptare me ortak Essegei SpA shoqëri e së drejtës italiane që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 100.000.000 Lek. Administrator i shoqërisë është Z. Eugenio Rossato.

Selia e shoqërisë ndodhet në Njësinë Bashkiake Nr.2, Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Ap.61. Tiranë. Shoqëria është regjistruar në organet tatimore të rrethit Tiranë me NIPT K71624027U.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhimi i energjisë elektrike.

Numri mesatar i punonjësve gjatë vitit 2020 është 34 punonjës (2019: 35).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 datë 30 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime mbi efektet pandemike në parimin e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme, inventari dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/LEK	123.7	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogarituri mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit në %
Ndërtimore	5
Makineri e Pajisje	20
Mjete transporti	20
Pajisje zyre	20
Pajisje kompjuterike	25
Të tjera	20

iv. *Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	63,564,853	36,217,260
Llogari rrjedhëse	63,564,853	36,217,260
Mjete monetare në arkë	246,391	574,071
	<u>63,811,244</u>	<u>36,791,331</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
FTL sha- OSHEE Group	32,434,013	
OSHEE për fatura në proces certifikimi		37,317,714
	<u>32,434,013</u>	<u>37,317,714</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paradhënie për personelin	500,480	663,948
Tatimi mbi fitimin i mbingarkuar	-	3,422,191
Detyrim doganor i mbingarkuar	12,513	8,406
Garanci të ndryshme	240,464	240,464
Tarifë aplikimi ERE për licencën e re	300,000	500,000
Pagesat e kryera në lidhje me çështjen gjyqësore me Sigal UGA	995,387	995,387
Zhvlerësim i pagesave të kryera në lidhje me çështjen gjyqësore me Sigal UGA	(995,387)	(995,387)
Taksë gjyqësore 1% për çështjen ndaj OSHEE	672,102	672,102
Provizion i krijuar për shpenzimet gjyqësore 1%	(672,102)	(672,102)
Taksa Bashkia Selenicë	4,600,000	2,600,000
Provizion i krijuar për çështjen e taksave lokale Bashkia Selenicë	(4,600,000)	(2,600,000)
	<u>1,053,457</u>	<u>4,835,009</u>

7. Inventarë

Inventari më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Materiale të tjera	206,747	-
Lendë djegëse	193,880	56,640
	<u>400,627</u>	<u>56,640</u>

8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të shtyra	1,701,632	1,594,574
	<u>1,701,632</u>	<u>1,594,574</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Të tjera	Asete në proces	Totali	AAJM
Gjendja më 1 janar 2019	188,361,456	300,035,038	3,534,549	5,697,441	616,800	498,245,284	1,755,700
Shtesa	5,360,798	6,818,385	746,340	668,808	660,750	14,255,081	-
Transferime	1,277,550	-	-	-	(1,277,550)	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	194,999,804	306,853,423	4,280,889	6,366,249	-	512,500,365	1,755,700
Shtesa	-	5,256,985	-	330,496	-	5,587,481	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	194,999,804	312,110,408	4,280,889	6,696,745	-	518,087,846	1,755,700
Gjendja më 1 janar 2019	48,612,250	247,730,330	2,297,047	4,162,058	-	302,801,685	1,619,200
Amortizimi i vitit	7,084,998	10,877,008	347,012	498,144	-	18,807,162	136,500
Gjendja më 31 dhjetor 2019	55,697,248	258,607,338	2,644,059	4,660,202	-	321,608,847	1,755,700
Amortizimi i vitit	6,965,128	9,882,014	327,366	521,425	-	17,695,933	0
Gjendja më 31 dhjetor 2020	62,662,376	268,489,352	2,971,425	5,181,627	-	339,304,780	1,755,700
<i>Vlera neto kontabël</i>							
Gjendja më 31 dhjetor 2019	139,302,556	48,246,085	1,636,830	1,706,047	-	190,891,518	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	132,337,428	43,621,056	1,309,464	1,515,118	-	178,783,066	-

10. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime ndaj furnitoreve	2,324,028	8,175,995
Llogari ndaj furnitorëve për fatura të pambërritura	367,665	574,131
	<u>2,691,693</u>	<u>8,750,126</u>

11. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura (afatshkurtëra)

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të pagueshme tregtare ndaj palëve të lidhura	13,479,465	22,180,607
Ortakë-Dividenti	-	1,245,000
	<u>13,479,465</u>	<u>23,425,607</u>

12. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrimi për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	618,653	646,575
Detyrimi për Tatimin mbi të Ardhurat Personale	703,873	624,752
Detyrimi për Tatimin në burim	1,100,351	1,792,591
Detyrimi për TVSH-në	2,261,028	3,119,307
Detyrimi për tatim fitimin	116,818	-
	<u>4,800,723</u>	<u>6,183,225</u>

13. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime për Pagën Neto	3,274,128	3,182,220
Detyrime per Taksen rregullatore te E.R.E.-s	1,003,822	486,603
Detyrime për Taksen e Shfrytëzimit të ujit dhe të tjera	-	16,803,928
	<u>4,277,950</u>	<u>20,472,751</u>

14. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100.000.000 LEK i zotëruar 100% nga ortaku ESSEGEI S.p.A shoqëri e së drejtës italiane më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>				<u>31 dhjetor 2019</u>			
	Kuota	Vlera nomina le	Kapitali i nënshkruar	%	Kuota	Vlera nomina le	Kapitali i nënshkruar	%
ESSEGEI spa	100,000	1,000	100,000,000	100%	100,000	1,000	100,000,000	100%
	<u>100,000</u>		<u>100,000,000</u>	<u>100%</u>	<u>100,000</u>		<u>100,000,000</u>	<u>100%</u>

Shoqëria ka fitim më 31 dhjetor 2020 në vlerën 40,279,131 LEK (2019: 31,921,516 LEK).

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga shitja e energjise elektrike	206,434,866	244,373,807
	<u>206,434,866</u>	<u>244,373,807</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	207,420,697
Zbriten autofaturat	
Faturuar punime ndërtimi për sponsorizim pasqyruar në zbritje të shpenzimeve të mirëmbajtjes	(636,640)
Faturuar rimbursim shpenzimesh pasqyruar në zbritje të shpenzimeve	(349,190)
Shitje të dekaluara në FDP që janë të ardhura në PASH	206,434,866
Te ardhura nga shitja e energjise elektrike	206,434,866
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP e TVSH-së	206,434,866
Të ardhurat nga interest	1,296
Të ardhura të tjera dëmshpërblime nga sigurimet	1,085,800
Fitim nga këmbimet valutore	564,386
Total të ardhura të deklaruara në FDP e Tatim Ftlimit	208,086,348
Diferenca	-

16. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe dëmshpërblimet nga sigurimet private, të cilat detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitim nga këmbimet valutore	564,386	118,317
Humbje nga këmbimet valutore	(66,432)	(226,014)
Demshpërblime nga sigurimet private	1,085,800	-
	1,583,754	(107,697)

mu

17. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Blerje materiale të para ndërtimore dhe elektromekanike	7,356,347	10,960,746
Lëndë djegëse dhe vaj lubrifikant	2,982,494	3,570,033
Inventar i imët	366,931	656,691
Konsumi ujit dhe energjisë elektrike	619,296	755,087
Mirëmbajtje dhe riparime	16,606,060	28,927,928
Prime të sigurimit për hidrocentralin	4,232,126	4,464,916
Prime të sigurimit për personelin	1,256,834	1,238,874
Konsulencë teknike dhe manaxheriale	29,823,800	29,562,200
Kontrolli i njohurive teknike	37,500	30,000
Royalties	30,965,230	39,099,808
Shpenzime udhëtimi e dieta	107,000	232,000
Shpenzime për licencen ERE	200,000	200,000
Taksa ERE	1,003,822	486,603
Tarifë e përdorimi te ujit	(16,803,928)	5,620,598
Tarifë për të drejtë përdorimi toke	15,000	235,294
Të tjera	10,000	-
	78,778,512	126,040,778

18. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime kancelarie e materiale pastrimi	177,932	360,826
Qira	2,181,084	2,244,939
Mirëmbajtje për zyrat - pajisjet informatike	50,263	36,180
Mirëmbajtje riparime automjetet	1,668,860	1,397,940
Prime të sigurimit automjetet	95,399	96,398
Konsulencë ekonomike, juridike	4,543,444	2,870,417
Kuota anëtaresimi, pjesëmarrje në panair e abonime	742,616	301,533
Shpenzime për ambientet e perbashkëta e të tjera	342,645	272,791
Shpenzime udhëtimi/dieta	892,604	1,246,934
Shpenzime telefoni dhe interneti	561,435	582,921
Shpenzime bankare	186,531	342,323
Taksa vendore e të tjera	885,986	875,686
Shpenzime për sponsorizime	773,968	123,380
Shpenzime për pritje	355,000	856,474
Shpenzime restoranti	1,034,845	1,178,713
Shpenzime transporti	28,000	-
Shpenzime administrative noteriale	31,900	188,700
Shpenzime të tjera	1,550,085	1,207,422
	16,102,597	14,183,577

Shërbimi i dhënies së sigurisë dhe auditim nga shoqëria Mazars për vitin 2020 është në vlerën 1,475,993 Lek.

19. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga dhe shpërblime	40,721,016	40,983,913
Shpërblim për punonjësit për raste fatkeqësie	30,000	30,000
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	4,477,638	4,565,293
	<u>45,228,654</u>	<u>45,579,206</u>

Numri mesatar i punonjësve gjatë vitit 2020 është 34 punonjës (2019 : 35)

Struktura e stafit është paraqitur si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Administrator	1
Staf tjetër Administrate	7
Inxhinier	2
Staf tjetër Operacional	24
	<u>34</u>

20. Provizione dhe zhvlerësime

Provizionet dhe zhvlerësimet detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Provizion i krijuar për taksat lokale	2,000,000	1,000,000
Provizion i krijuar për taksat gjyqësore	-	144,331
	<u>2,000,000</u>	<u>1,144,331</u>

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Gjoka dhe penalitete	1,043	104
	<u>1,043</u>	<u>104</u>

22. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet interesi dhe shpenzime të ngjashme përfshijnë shpenzimet dhe te ardhurat e interesit. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga interesi dhe kamat vonesat ngjashme	1,296	1,896
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	-	(158,733)
	1,296	(156,837)

23. Shpenzime të tjera financiare

Shpenzimet te tjera financiare përfshijnë shpenzimet dhe te ardhurat nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitim nga këmbimet valutore	-	-
Humbje nga këmbimet valutore	-	(1,271)
	-	(1,271)

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<i>Fitimi para tatimit</i>	48,213,177	38,216,344
Total shpenzime të panjohura	4,680,463	3,749,174
Shpenzime për pritje përcjellje	-	123,353
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	1,043	104
Shpenzime zhvlerësimi (provizioni)	2,000,000	1,144,331
Shpenzime të tjera pa faturë të rregullt tatimore	2,679,420	2,481,386
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	52,893,640	41,965,518
Humbje fiskale e mbartur		
Tatim fitimi @15%	7,934,046	6,294,828
	40,279,131	31,921,516

25. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Essegei Spa	-	8,338,213	-	12,435,663
Idro Power Service	-	5,141,252	-	10,989,944
	-	13,479,465	-	23,425,607

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Essegei Spa		45,877,130	-	53,882,307
Hydra Energia		410,753	-	407,648
Balkan Green Energy	349,190		348,884	-
Idro Power Service		33,229,046	-	44,828,187
	349,190	79,516,929	348,884	99,118,142

Shpërblimi total i dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është 413,196 LEK (2019: 413,196 LEK).

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

BUGEMIO ROSATTO
B. Rosatto

mazars

Str. Emin Duraku,
B. "Binjaket" No. 5
Tirana, Albania

Tel: +355 4 2222 889
Tel: +355 4 2278 015
www.mazars.al